



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 25.03.2025

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 42.1, nenit 38, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi : 632-21-4538-5-2-1 dhe nr.brendeshëm 632-21-077-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-29303, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiave ligjore, me dt.25.03.2025, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

1. Për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, si pasojë e COVID-19 që shkaktoi vonesa të papritura dhe të pakontrollueshme në realizimin e projekteve publike, mungesa e zgjidhjes së problemit të mureve të cilat janë në pronë private dhe kanalizimet e kryera nga kompanitë tjera të cilat kanë qenë të përfunduara dhe kanë penguar në punime, ishte e pamundur të bëhen devijime në rrugë, kontrata me numër të prokurimit : 632-21-4538-5-2-1 dhe nr.brendeshëm 632-21-077-521, dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-29303, e nënshkruar me datën 30.09.2021, me titull “ Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve të Pika e Zezë-Pjesa -II-të ”, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Roza Komani B.I., Rr. Domenik Pergega p.n., Gjakovë, me nr.unik 811129726,, **NDËRPRITET ME MARRËVESHJE MES DY PALËVE KONTRAKTUESE.**
2. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës dhe Kryesi i punëve, në pajtim me nenin 42, paragrafi 42.1 dhe nenin 38, paragrafi 38.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), si dhe kërkesën e dt.21.03.2025, të menaxherit të kontratës, kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.
3. Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin e prokurimit për “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve te Pika e Zezë-Pjesa -II-të”, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Roza Komani B.I., Rr. Domenik Pergega p.n., Gjakovë, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës së dërguar në Zyrën e Prokurimit me date 21.03.2025, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës.

Me date 24.03.2025, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për ndërprerje me marrëveshje të kontratës” të kryesi i punëve Roza Komani B.I., Rr. Domenik Pergega p.n., Gjakovë.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave të Prokurimit Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini



Kryetari i Komunës



Faton Gutaj



Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Infrastrukturë;
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
Menaxherit të kontratës;
Organit Mbikëqyrës;
Arkivës së Komunës.